

## INTERVISTË ME VOTIM DEMIRIN

Prizren | Data: 5 maj, 2017

Kohëzgjatja: 40 minuta

Të pranishëm:

1. Votim Demiri (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni m’u prezantu, edhe a kishit mujt me, me na tregu për historinë e familjes juj, t’jujën edhe jetën në Prizren?

**Votim Demiri:** Po, quhem Votim Demiri. Kam 72 vjet. Shkollimin kam kry në Beograd. Jam me profesion inzhinier i teknologjisë. Pastaj, mas studimeve kam punu në Prizren, edhe gjithmonë kena jetu në Prizren. Me kohë jam bo drejtor i fabrikës ma t’madhe në qytet. Mas disa viteve m’çojnë në Prishtinë. U bona anëtar i qeverisë të atëherëshme edhe kam qenë i ngarkumë me marrëdhانيت ekonomike me botën e jashtme. Mas dy vite, m’çojnë në Francë si Kryetari i Odës Ekonomike të ish-Jugosllavisë ku kam qëndru katër vjet, edhe kur jam kthy u pensionova.

Po, jeta në Prizren dallohet prej viseve tjera të Kosovës. Osht’ opinionimi im personal, por kurgjo nuk e ka vërtetu që Prizreni e ka ni shkallë ma t’madhe të tolerancës, mirëkuptimit mes njerzve, etnicitetet tjera, mes feve.... Kështu që, mas ‘99-shit kur komuniteti hebraik i Prishtinës u shpërnda t’u shku në Izrael e... vetëm hebrejtë që ka jetu në Prizren, kemi mbetë në Prizren.

**Erëmirë Krasniqi:** A kishit mujt me u kthy ma herët? A kishit mujt m’u kthy në fëmininë e juj të hershme, me na tregu diçka për jetën në Prizren mas Luftës Dytë Botërore?

**Votim Demiri:** Mas Luftës Dytë Botërore kemi jetu në ni shtet sekullar, edhe tash jemi shtet sekullar, por pjesa dërmuse e njerzve ka qenë ateistë. Çka e di une për religjionin? E di prej nonës në shpi. Kur kanë qenë festat hebreje, nona na tregojke, përgatitke çka duhet me përgatit për atë ditë, por në kuadër të familjes, bie fjala, kur kemi pasë festën e *pasoverit*, nona ime gjithmonë kur bojke oriz me pulat ma jepke kambën e pulës, por për *pasover* vetëm krahun më jepke sepse sipas adetit hebreje duhet fmija me mësu me fluturu. U ankojsa unë, “Bre mami kështu... a s’bon?” Bie fjala.

Ju e dini atë frytin nektarinë, nari? Ai ka 653 kokrra. Por, për çdo kokërr osht’ ni udhëzim i religjionit hebraik shka duhet me bo. Kështu që osht’ ni religjion, mos me thanë i randë, por problemi o që as nuk mundesh me u bo hebrejë as nuk mundesh me dalë prej religjionit. Aty vendosë de-n-kaja [kodi gjenetik], gjaku. Gjatë jetës mundesh me u pasivizu, mos me u marrë me këto sendet, por me dalë prej asaj nuk ka, nuk ka mënyra që mundesh me dalë.

E si ka qenë jeta këtu kur dihet që mbi 95 përqind të njerzve janë muslimanë. Ekzistojnë edhe fetë tjera ortodoksia serbe, kristianizmi, katolicizmi, protestantizmi në kohën e fundit u bo, por Prizreni o interesant që kurrë ni problem fetar nuk ka ekzistitu deri, deri sot. Fund fundit ato janë virtytet e

popullit shqiptar. Vet populli shqiptar mrenda vetit e ka tri fe, por ni komb janë. Ka qenë ni jetë e qetë, normale, por sot do sendet janë ndryshu. Ma merr mendja edhe ma mirë do t'bohet, por deri sa t'ia kalohet kjo situata e ekstremisteve... por s'ma merr mendja që në Kosovë mundet rrënjat e forta me.... Sepse gjenerata jonë, edhe femrat edhe mashkujt, janë [në] farmerka, janë, janë të edukum në ni mënyrë tjetër.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë familje tjera hebraike në Prizren?

**Votim Demiri:** Po (kollitet).

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë raporte keni pasë, a qysh jeni identifiku me njoni tjetrin?

**Votim Demiri:** Nona ime ka mbetë në Prizren, edhe ni gru e cila u martu për ni prizrenas shqiptar këtu. Edhe prej këtyne dy grave u kriju... sot e kemi 16 familje në (kollitet), në Prizren. Për fat t'keq...

**Erëmirë Krasniqi:** 16 anëtarë apo 16 familje?

**Votim Demiri:** 16 familje, tu e llogaritë familju, familjen burrë e gru edhe fëmitë sa kanë. Po, për fat të keq hebretë që kanë jetu në Vushtri, në Novobërdë, në Prishtinë nuk ekzistojnë më, nuk ekzistojnë më. Realiteti. Cilat janë perspektivat t'jetesës këtu? Ma merr menja t'u e ndërto ni, ni sistem laik sekullar ka vend për të gjithë. Jam i bindur. Por, nuk mundet përpara ni, ni, ni fëmi me u lindë në Prizren pa e ditë praktikisht tre gjuhë. Prizreni e ka atë veti: shqipen, serbishtja – boshnjakishtja qysh doni, edhe turqishtja e vjetër. Thujshin në Prizren, “Dita sotit, ju nuk dini në atë dyqan qysh po flet ai”. Por t'u e ditë tre gjuhët ai komunikimi shkon lehtë.

**Erëmirë Krasniqi:** Në çfarë gjuhe keni folë ju në familjen e juj?

**Votim Demiri:** {ngre vetullat në shenjë që nuk ka dëgju pyetjen}

**Erëmirë Krasniqi:** Në çfarë gjuhe keni folë ju në familjen e juj?

**Votim Demiri:** Ah, na... babën shqiptar ka pasë edhe ai ka qenë partizan, ka luftu. U martu me nonën. E kemi folë edhe shqip edhe turqishtën e vjetër kemi folë. Por, nuk ka qenë ni qëllim posaqëm kështu me folë. Komunikimi shkojke lehtë. Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, zotëri Enver Hoxhaj, ka qenë në festimin e Ditës Turqisë, edhe ai dul edhe po thotë atë shka kam mendu unë gjithmonë praktikisht, “Në Prizren filloni konverzimin [bisedën] në ni gjuhë edhe përfundoni atë konverzimin në gjuhën e tjetër”. Jena mësu ashtu.

Por, komunitetet hebraike në regjion e kemi kontaktet të rregullta. Edhe organizatat hebraike në botë na kanë pranë si komunitete hebraike të Kosovës, që jemi anëtarë, bie fjala, ekziston Parlamenti Evropian i Hebrejve. Edhe kur kemi pasë mbledhje së pari në Brisel [Bruksel] në institucionet e Parlamentit Evropian kemi mbajtë. Edhe na kanë folë krejt këta që jonë nëpër televizione sa tash që po lajmërojnë prej atje, Ulrike Lunachek, e.... Mbledhjen e dytë kemi pasë në Vjenë, sepse qendra e Vjenës ka qenë hebrejve edhe aty gjindet ni muzeumi, edhe aty kena pasë. Na kanë ardhë me na mbajtë fjalën, e kanë pasë Parlamenti, antarët të Parlamentit Franqez.

Para ni muje e kena pasë mbledhjen në Gjermani në Bundestag, në Parlamentin e Gjermanisë, ku na ka folë dora e djathtë e Angela Merkelit, Petra Pauzov ja Petra Pau. Kështu që, jemi të angazhum me këto rrjellat [rrjedhat], e kemi muhabetet tona...

**Erëmirë Krasniqi:** A kishit mujtë me na tregu historinë e nanës ju? Privatisht kur folëm tingëlloj shumë interesant qysh ajo ju ka bashkangjitur partizanëve. Po edhe krejt historia...

**Votim Demiri:** Po...

**Erëmirë Krasniqi:** ... e saj çka ka ndodhë, qysh ka përfundu?

**Votim Demiri:** Po, komuniteti ma i madh i hebrenjëve ka qenë në Prishtinë, edhe nona ime u lindë në Prishtinë. Deri në vitin '4... 1943, deri sa ka qenë okupimi i Italisë në Kosovë edhe në viset shiptare, hebretjtë në këto treva nuk kanë pasë atë solucionin final të Hitlerit, nuk ka shku deri n'fund. Po mas kapitullimit të Italisë, gjermanë u rikthyn në Kosovë edhe filloi deportimi i hebrenjëve. Por, ironia e jetës a e historisë... shumë kam qenë t'interisum, interesum me ditë për babgjyshin, për gjyshen, për dajë shka u bo edhe qysh kanë vdekë, kur kanë vdekë.

Edhe ironia e jetës, kur kam shkru ni letër, në Qendër Memoriale të Holokaustit në Bergenberg të Gjermanisë, ata ma kanë çu listën e saktë. Gjermanët kanë qenë gjithmonë pedantë. Me datën e deport, lindjes, deportimit, vdekjes, krejt ato e kom tash. Mas asaj...

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni ma detalisht, kush ka përfundu në kamp të koncentrimit?

**Votim Demiri:** Babgjyshi, Hajemi, babgjyshja, gjyshja, edhe daja ma i madh. Dy tezet ma t'vogla, këtu janë fotografi {tregon me dorë fotografinë në mur}, ata kanë qenë t'vogël, por ata kanë qenë të deportum në '43-shin. Edhe Lufta Dytë Botërore shpejt përfundoi, nuk kanë ardhë në rend praktikisht. Nona ime me '41-shin shkoi në partizane, e ka pasë 18 vjet, me luftu fashizmin. Kjo puna nuk ka lidhje me sistemin i cili do ndërtohet në Kosovë edhe në ish-Jugosllavi. Nuk ka pasë lidhje me komunizmin, bie fjala, po ajo shpëtimi jetës.

Kur përfundoi Lufta, me qenë se ka vendosë me u martu për babin tim, ai o prizrenas, edhe kanë vendosë me mbetë këtu. A tezet e mia ma t'vogla, ka qenë ni punë t'organizume për hebretjtë në '48-tën me shku në Izrael, ata shkun atje. Kanë formu familjet. Sot janë gjallë, bie fjala, jetojnë. Nona ime gjithë jetën e vet, mas Prishtinës edhe Luftës ka kalu në Prizren. Këtu ka jetu. Ka folë gjashtë gjuhë. Qasi tipi. Prej shkollës ka pasë vetëm maturën, por i shkojshin gjuhët edhe ajo i përvetsojke shpejtë. Edhe turqishtën, edhe shqipën, edhe frangjishtën, edhe spanjollishten normal, italishten e krejt këto sa... Na t'u e kqyr nonën, ngadalë-ngadalë, hajde...

**Erëmirë Krasniqi:** Sa fëmijë keni qenë ju? Po mendoj sa vëllazën e motra? Sa vëllazën e motra i keni?

**Votim Demiri:** Ni, kom ni motër e cila u martu në Malin e Zi. Jeton në Bar që 40 vjet. Edhe ni vëlla e kom kojshi. Osht' mjek, internist. Ni vëlla edhe ni motër. Po në momentin kur kanë vendosë me shku në Izrael kemi qenë t'lindun edhe unë edhe motra. Nona ime nuk ka dashtë me bo rrizik tash me fmitë me shku, edhe mbeti këtu edhe nuk ka gabua në fund të fundit. Na e nijmë vetën që jena prizrenas, autokton, gjithmonë... edhe në këtë mahallë gjithmonë kena qenë.

## Pjesa e Dytë

**Votim Demiri:** Eh, shka me ju tregu dishka tjetër...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ua ka kultivu nana juj ndjenjën ose sensin e qatij identitetit hebraik? A kishit mujtë me na tregu? Identitetin hebraik, a ka punu me ua kultivu najqysh? Po mendoj krejt qito fotografija qysh ua ka...

**Votim Demiri:** Po...

**Erëmirë Krasniqi:** ... prezantu ajo? Kush kanë qenë këta njerëz, çka kanë përfaqësu për juve?

**Votim Demiri:** Osht', osht' ni pytje e randë. Por, kur dojmë me lavdu hebrejtë na gjithmonë e kena do parametra që tregojmë që kështu o, faktet. Në botën materiale, ekzakte, formula e fundit e Einstein ende vlen. Deri sot, nesër shka bohet... Por, në botën jo-materiale, nuk mund tija kalohet veprimi i Sigmund Frojdit, osht' bazë e të gjitha shkencave spirituale. Pastaj, kur dojmë me lavdu, a vërtetat janë, gati gjysa e nobelistave janë hebrejtë. Kështu njeri me menu a o komisioni që e ndanë ato çmimet, a o vet hebrejtë? Që mundemi me thanë, a nuk osht' e vërtetë vallai.

Por, osht' ni logjikë tjetër, por ni logjikë e cila çonë kah adaptimi situatës, edhe gjithmonë kanë pranë sistemin e jetës atje ku jetojnë. Realisht me fol, une njof krejt hebrejtë e regjionit edhe jemi tuj bisedu... hebrejtë e Bosnjës sefardik [*sephardic*] si na, anojnë për Bosnjen, hebrejtë kroatë për Kroacinë, hebrejtë e Serbisë për Serbinë. Edhe na të Kosovës jemi më së pari kosovar. Ajo osht' nifarë, si thuhet, nifarë *denominatori komen*, ni...

**Erëmirë Krasniqi:** I përbashkët.

**Votim Demiri:**... përbashkët. Por, janë do temat ku hebrejtë bashkohen, problem anti-semitizmit, problem rrjedhave t'botës shka të bohet sepse janë nëpër... edhe.... Më duket që me 2020, pastaj janë t'u e punu në atë drejtim, që hebrejtë të gjitha pikave t'botës kanë me thonë për veti që janë izraelitë, sepse në këtë moment edhe religjioni hebraik ballafaqohet me problemin me ni indentitet fluid, jo i kapshëm. Por, këto rrjedhat kena me kqyr si kanë me shku, por deri sot diaspora hebrejëve osht' ma e madhe se hebrejtë në Izrael. Po mas, po thojnë, mas 2020-shit, kjo puna komuniteti ma i madh hebrejve ka me qenë në Izrael. Ashtu po thojnë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë probleme me anti-semitizën në këtë rajon? A keni përjetu diçka të tillë?

**Votim Demiri:** Po, osht' ni, osht' ni shkrintare hebraike e cila, An Harendt [Hannah Arendt], e cila thotë, tha, "Anti-semitizmi nuk ekziton vetëm në hanë". Por, nuk osht' problemi ri, hebrejtë dinë si me u ballafaqu me këto problemet, por jetesa në Prizren e ka më së paku ndoshta. Lirisht jemi t'u e dalë, kurrë naj problem a. Sigurisht keni ndigju për Robin Hudin? Po Robin Hudi i Gjermanëve, nifarë Robin Hudi quhet Till Eulenspiegel edhe shka bojke ai? Ai shkojke prej katundi n'katund me ni kanap [litar i fortë], edhe me ni shtagë e ballansojke edhe ecke, edhe fëmitë e kqyrshin. Une vetën e kqyri, e shoh si

Till Eulenspiegel, e ballansoj pa me hup karakterin, pa me u largu prej vetvetës, por duhet me ditë, duhet me ditë.

Kojshinë e parë e kom “Teqen e Dervishëve”, muzeumi [e përmirëson] xhaminë... në këtë anë ku keni kalu është shkolla ma e malle e ortodoksisë serbe “Bogosllovi”, ma e malle se në Serbi. E prapë xhamija, prapë kisha, prapë edhe tjetra. Me të gjithë jemi t’u e folë, po përzihen, po bojme muhabete... por, jeta na dikton që duhet me njerëzit me bisedu. Duhet me bisedu. Kërkush nuk mundet me ndrru, as libri i shejtë i hebregjeve nuk e ndrron librin e shejtë të muslimanëve, as libri i shejtë i muslimanëve nuk e ndrron Biblën. Ajo ekziston.

E përveç asaj, ka ni milion pytjet në të cilën duhet me dhonë përgjegje, jo vetëm na, të gjithë. Para gati ni muj ka ardhë ni Kardinal i Vatikanit në Prishtinë. Po bisedoj me ate. Ai po më thotë, “A e din që tre religjionet janë në, në botë?” Neve na shkon mendja menihere muslimanizmi, kristianizmi, ai hebraizmi. “Jo”, tha, “njona osht’ ‘Shinto’, zhaponezt [japonezët] edhe këta që e kanë, e dyta osht’ ‘Hindu, Vishna’, e treta janë ‘Religjionet e Ibrahimit, Abrahamit’”. Kur po thotë ni, ni Kardinal i Vatikanit këte, po e vërteta o, e vërteta.

Hebregjtë nuk e hajne mish derrit, bohen synet e, këte këte këte... muslimanët po ashtu. Realisht me fol Jezusi ka qenë ni hebre i cili ka kriju fejen kristianizmin, por ai osht’ i shejtë edhe për muslimanët. Vështirë o me kuptu këto sende, por realiteti o kësi lloji.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni me na tregu prej asaj çka ju ka tregu nana ju për komunitetin e hebregjeve në Prishtinë? Qysh ka qenë i organizum, ku jonë eduku, ku kanë jetu? Qesi informata me na jep.

**Votim Demiri:** Po nona ime deri në moshën 18 vjeçare ajo ka qenë në shkollë të hebregjeve edhe në gjimnaz ka qenë. E ka pasë ni... ka qenë ni, ni jetë në Prishtinë, si tregojke ajo, normale, ni jetë normale deri në fillimin e Luftës Dytë Botërore. Mas asaj sendet janë prishë.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh kanë qenë t’organizum? Kanë shku, i kanë pasë shkollat e veta a?

**Votim Demiri:** Në municipallitin [*municipality* – komunë], kuvendin domethanë, dyqanet e veta, shtëpitë e... kanë qenë t’organizum por...

**Erëmirë Krasniqi:** N’cilat pjesë kanë jetu?

**Votim Demiri:** {ngre vetullat në shenjë që nuk ka dëgju pyetjen}

**Erëmirë Krasniqi:** N’cilën pjesë të qytetit kanë jetu?

**Votim Demiri:** Cilën pjesë? Teatri ku o? Rruga mas Teatrit. Ajo pjesa mas parlamentit, osht’ ni qebaptore “Sarajeva” m’duket quhet, krejt atë rrugicë aty, krejt janë të hebregjeve. Përballë “Swiss Diamond Hotelit” janë do shtëpija të hebregjeve të cilat ende kanë mrenda shpisë shenjat e Davidit, edhe në dita sotit. Kam shku m’i pa. Po kanë pasë ni jetë normale, ashtu me thanë. Por, bota ka kalu do sfida të cilat e kanë prishë atë rendin. Por, nona ime e ndijke vetën, edhe këta tjerët në Prizren që kanë mbetë, e kanë ni vetën qetë edhe mirë edhe kanë mbetë në Prizren e, qe edhe dita sotit na fëmitë atynve ende po vazhdojmë.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh i keni rritë ju fëmijtë e ju?

**Votim Demiri:** Fëmijtë e mi... ni vazjë e kom në Izrael. Ajo punon në Aeroportin e Telavivit. Vajza më e madhe është në New York edhe është nëpunëse e Konzulatit të Kosovës në New York. E ka dy vajzat, ato janë me neve këtu. Elle djali është i martum edhe punon në bankë. Edhe ai ka ni vajzë. Jeta po ecë ngadale. E kqyrim qysh, si kena me bo.

**Erëmirë Krasniqi:** A keni naj tregim familjar që kishit pasë qef me na tregu? Që... ma, ma interesant për juve, që kishit mendu është ma karakteristik. Po meno diçka prej qetyne fotografive, diçka që ju kujtohet, që na s'kishim ditë vet me, m'i ra... me kujtu diçka që jeni konë pjesë e...

**Votim Demiri:** Bie fjala, {tregon me gisht njëren nga fotografitë} gratë që kanë jetu në atë periudhë, para Luftës Dytë Botërore, e kanë pasë veshjet sikurse të gjitha gratë e Kosovës gati, aty, qe si, si asht' veshja.... Por, religjioni si religjion o çashtja, çashtja e zemrës edhe pranimit atyne rregullave. Ajo s'do me thanë kurgjo me, kur dalish në sokak që s'ka nevojë me u ndrru, me u dukë ndryshe. Duhet me pranu jetën me kojshitë, me njerëzit e qytetit e...

**Erëmirë Krasniqi:** A thatë ju, a m'u dukë a thatë që ju kujtohet kur është rrëzu edhe Sinagoga e dytë?

**Votim Demiri:** M'kujtohet. Unë kam pasë 17 vjet. Ka qenë n'kohën e socializmit këtu. Nona ime me atë tezën kanë kajtë. Nuk kam kuptu situatën bash çka u ndodhë, por m'kujtohet ajo. Unë 17 vjet kam pasë. Por t'u e jetu në ni sistem laik, nuk ka pasë nej dishka, sipas meje, dramatike. Na kanë rrxu Sinagogën, unë nuk kam mujtë me kuptu une atëherë.

**Erëmirë Krasniqi:** A dini a ka pasë naj kundërshtim prej komunitetit?

**Votim Demiri:** Po, sigurisht ka pasë por sistemi atëherëshëm nuk kanë ndigju.... Ka pasë xhamija që janë shëndrru në magazat [depo], kishat po ashtu... ni Sinagogë plus, jo... ka qenë ni sistem tjetër. Por, tash diqysh u rikthy çashtja e religjionit por të gjithë po mundohemi me pasë ni, ni linjë t'kuqe deri n'ku osht' religjioni, a shka o pastaj shteti llaik. Ajo ka rëndësi shumë të madhe. Çdokush mundet n'shpinë e vet me mbajtë religjionin, por, kur ke me dalë n'rrugë s'ke drejtë ti me imponu mendimet tuja religjionit tjerëve. Duhet me pranu njeriun si njeri. Nuk ka rrugëdalje tjetër.

**Erëmirë Krasniqi:** E a dini deri kur ka qenë n'fukcion Klubi i Boksit? Në funksion t'komuniteteve? Te kjo fotografija këtu?

**Votim Demiri:** {tregon me gisht drejtë njëres fotografi} Po, ajo...

**Erëmirë Krasniqi:** Deri kur është përdorë?

**Votim Demiri:** ... ajo u inçizu, me 1929 u inçizu. Edhe deri në fillimin e Luftës Dytë Botërore ka ekzistë.

**Erëmirë Krasniqi:** E mas asaj është transformu a?

**Votim Demiri:** Po. Pastaj erdh sistem tjetër edhe atë ndërtesën e kanë dhonë Klubin e Boksierve, bie fjala. Po tash sistemi, ky establishmenti politik i Kosovës, jam t'u e bisedu gati me të gjithë, edhe me ata të Parlamentit, edhe Presidentit e... po dojnë me na kompenzu, edhe për shkak atynve kanë vendosë që në Prizren ni ndërtesë me na dhanë për 99 vjet, që na kur kemi mysafirtë ose naj festë... Nuk pranova unë që me qenë konotacion religjioz i asaj ndërtese, por, me bo ni, nifarë muzeumi i cili ka me tregu afërsinë e shqiptarve me hebrevje. Ashtu u pranu ajo. Jemi n'fazën kur e bojmë ate.

Disa konferenca ndërkombëtare kemi mbajtë, qe këtu [tregon një fotografi] kanë ardhë edhe prej, prej vendeve tjera kanë ardhë edhe hebrevjtë, edhe... Qëllimi osht' për me tregu që shiptartë kanë qenë ndaj hebrevje, asni shtet në Evropë nuk mundet me u lavdu që u rritë numri hebrevje gjatë Holokaustit, sikurse shqiptartë që mundet me thanë atë. Këto janë realitetet.

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë raporte keni me organizatat që me, që merren me t'dhanat e shqiptarve që kanë shpëtu hebrenjë gjatë Luftës Dytë Botërore? Janë disa m'doket, organizata...

**Votim Demiri:** Po ekzistojnë organizatat, po bisedon me do ma e forta prej tynve osht' ajo *JDC Jewish Distribution Committee* në New York. Ata e kanë atë lami për heritazhin [*heritage*] për trashëgimin, e me ata jonë tu e bisedu. Ka, ka, kanë tyrlifar organizatat. Na u bonëm anëtarë edhe Parlamentit Evropian të Hebrevje, edhe *World Jewish Congres* [Kongresi Botëror i Hebrevje], edhe e kanë organiztë Evro-Azisë, ajo sarita aty {tregon me dorë fotografinë} asi që... na kanë pranu, e po bisedojmë, e ku ka naj problem e bashkarisht e kqyrim.

Por, të gjitha muhabetet janë në formën e spiritualitetit, jo me pare me... Asni derë nuk e ka tro, nuk e kemi trokitë me, me thonë e duhet kështu, duhet pare, anej. Kurrë. E tash për rregullimin e kësaj ndërtese që na kanë dhanë i thashë Kadri Veselit, a duhet me e përmend a, "Qofse keni vendosë me na dhanë, atëhere rregulloni ashtu si duhet". Nuk ka as derë, as dritare, as... "Rregulloni e na kena me hi në aty". Por, ata vet kanë me bo.

**Erëmirë Krasniqi:** E sa është i madh komuniteti juj sot? Sa...

**Votim Demiri:** Mementalisht i kemi 56.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh i keni identifiku?

**Votim Demiri:** [ngre vetullat në shenjë që se ka dëgjuar pyetjen]

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh i keni identifiku? Qysh i keni gjetë?

**Votim Demiri:** 56 vetë janë. E kanë, e kemi rregullisht ato festat e shtunës, *Shabatit*. Po aty ekzistojnë do normat. Në qoftëse nuk ka nimdhjetë mashkujt, nuk mundesh me bo. Po na kemi, na kemi atë *Shabatit* e bojmë. Kur vijnë festat hebraike edhe ata po shënojmë. Por tash ato festat tjera shënojmë nëpër restorante...

**Erëmirë Krasniqi:** Ok.

**Votim Demiri:** ... mblidhemi edhe n'restoran shkojmë. Mirë o, mirë o. S'di sa kam mujtë me i thanë veç qikjo o situata.



**Erëmirë Krasniqi:** E çfarë prapavije kanë tjerët, anëtarët e komunitetit hebraik? A janë krejt të para Luftës Dytë Botërore apo a kanë ardhë ma vonë a ma herët, apo? Po menoj prej asaj çka dini, me qenë se i shihni nëpër këto takimet që i keni?

**Votim Demiri:** Mendoj që situata për hebrenjtë o ma mirë tash se përpara. Mendoj që ma mirë o, sepse edhe Ligji për Religjionet e Kosovës, osht' ni pjesë e lirisë personale t'njertzve. E kur ekziston ligji, atëhere osht' ni liri të cilën nuk e pengon askush. Por, jeta vazhdon. E kqyrim shka do t'bëhet prapë (qeshë).

**Erëmirë Krasniqi:** Ok. Shumë faleminderit!

